VENDIM
Nr. 56, datë 4.6.2015

AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE PËR VEPRIMTARITË, TË MIRAT DHE SHËRBIMET KULTURORE

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:
Arben Ahmetaj kryetar
Mimoza Dhëmbi anëtar
Dareka Dariu anëtar
Ahmet Mançellari anëtar
Anduena Dedja anëtar,

në mbledhjen e tij të datës 4.6.2015, shqyrtoi dokumentacionin e dërguar nga Ministria e Kulturës dhe vendosi të lejojë ndihmën shtetërore për veprimtaritë, të mirat dhe shërbimet kulturore në përputhje me parashikimet e nenit 13, shkronja "ç" të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar.

I. PROCEDURA

1. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), me shkresën nr. 8436, datë 9.12.2014 dhe nr. 592, datë 22.1.2015, i kërkoi Ministrisë së Kulturës informacion në lidhje me vlerën e fondeve të miratuara nga buxheti i shtetit, të shoqëruar me përshkrimin e skemës së ndihmës/mbështetjes, qëllimin e përdorimit, përfitues/it, kohëzgjatjen e skemës për punimet e mirëmbajtjes, të restaurimit dhe të rigjallërimit të monumenteve të kulturës dhe muzetë, si edhe mbështetjen financiare për veprimtaritë kulturore në fushën e artit dhe kulturës dhe prodhimeve kinematografike.

2. Me shkresën nr. 279/1 datë 10.4.2015, Ministria e Kulturës paraqiti të dhënat e kërkuara pranë Sektorit të Kontrollit të Ndihmës Shtetërore, në Drejtorinë e Tregut të Brendshëm, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS) për skemën e ndihmës shtetërore në favor të personave, juridikë dhe fizikë aktivë, ofrimin e veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore[1].

II. PËRSHKRIMI I MASËS

3. Skema ka si qëllim mbështetjen dhe nxitjen e kulturës, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe muzeve, përmirësimin e strukturës së industrisë shqiptare të filmit, cilësinë dhe shumëllojshmërinë e saj.

4. Dhënës i ndihmës është Ministria e Kulturës, si ministria përgjegjëse për zbatimin e politikave kulturore dhe Qendra Kombëtare e Kinematografisë, si institucioni përgjegjës për shpërndarjen e fondit buxhetor për gjinitë e filmit (artistik, dokumentar e të animuar).

5. Aktivitetet të cilat përfitojnë nga ndihma shtetërore janë si më poshtë:

- Për prodhimin artistik, edukimin, rritjen e zhvillim audiencash, ngritjen e kapaciteteve, kryerjen e aktiviteteve kulturore, hulumtim dhe zhvillim, etj.;
- Për punimet e mirëmbajtjes, të restaurimit, të zbulimit dhe të studimit të vlerave të trashëgimisë kulturore dhe muzetë;
- Për projektet kinematografike, prodhimin dhe shpërndarjen e filmave artistikë me metrazh të ndryshëm, filmave dokumentarë, të animuar, projektet për filmat indipendentë me metrazh të ndryshëm, etj.

6. Përfitues të ndihmës janë:

- Në fushën e artit dhe kulturës:

Personat juridikë dhe fizikë, të cilët paraqesin projektpropozimet që shprehin: ide novatore, qëndrueshmëri dhe vazhdimësi, garantojnë cilësi dhe profesionalizëm në realizim, mundësi për rritjen profesionale të artistit, sjellin zhvillim dhe gjallërim të skenës artistike e kulturore në Shqipëri, dëshmojnë respektimin e të drejtës së autorit.

- Në fushën e trashëgimisë kulturore dhe muzeve:

Personat juridikë dhe fizikë, të licencuar nga Ministria e Kulturës për restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, si edhe muzetë publikë.

- Në fushën e prodhimeve kinematografike:

Personat juridikë dhe fizikë, të cilët realizojnë vepra filmike dhe realizojnë tregtimin apo shpërndarjen e veprave filmike.

---

[1]Shqipëria u bë palë e Konventës për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Larmisë së Shprehjeve Kulturore më 17.11.2006, ku në nenin 4 përcaktohet se: "**Veprimtaritë, të mirat dhe shërbimet kulturore**" janë veprimtaritë, të mirat dhe shërbimet që në kohën kur janë konsideruar si një atribut, përdorim apo qëllim specifik, mishërojnë ose përcjellin shprehje kulturore, pavarësisht nga vlera tregtare që mund të kenë. Veprimtaritë kulturore mund të jenë qëllim në vetvete ose mund të kontribuojnë në prodhimin e të mirave dhe shërbimeve kulturore.

7. Baza ligjore: neni 26 i ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën", i ndryshuar, neni 19 i ligjit nr. 9386, datë 4.5.2005, "Për muzetë" dhe neni 5 i ligjit nr. 8096, datë 21.3.1996, "Për kinematografinë", i ndryshuar.

Referuar akteve ligjore të sipërcituara, si edhe mbi bazën e ligjit të buxhetit të shtetit, kryhet financimi dhe përdorimi i burimeve shtetërore për mbështetjen e projekteve kulturore, veprimtarisë së muzeve, si edhe mbështetja për industrinë shqiptare të filmit, duke e shtrirë zbatimin e tyre në vitet pasardhëse. Gjatë vitit 2015, nëpërmjet ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", skema parashikon dhënien e ndihmës në vlerën gjithsej 225, 75 mln lekë, e ndarë sipas kategorive:

- Në fushën e artit dhe kulturës: 47, 65 mln lekë (për 82 projekte fituese).
- Në fushën e muzeve: 70,1 mln lekë (muzeu Arkeologjik Durrës 56.6 mln lekë dhe për muzeun "Gjethi" 13.5 mln lekë).
- Në fushën e prodhimeve kinematografike: 108 mln lekë.

8. Procesi i përzgjedhjes. Aplikuesit e projekteve në fushën e kulturës duhet të përmbushin disa kërkesa, si p.sh. identifikimin e lidhjes së objektivit të projektit dhe qëllimit për të cilin jepet granti, etj.

III. VLERËSIMI

1. Ekzistenca e ndihmës shtetërore

9. Neni 4 i ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, parashikon se: "Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara."

10. Skema e njoftuar nga Ministria e Kulturës lejon vetëm një numër të caktuar dhe të përzgjedhur të personave fizikë dhe/ose juridikë, muze publikë për të përfituar burimeve shtetërore, fonde nga buxheti i shtetit, për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve të tyre që lidhen me kryerjen e aktiviteteve sipas fushave, në pamundësi të burimeve të veta financiare[2,3,4]. Ministria e Kulturës[5,6] me fonde nga buxheti i shtetit mbështet projektet e paraqitura nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, të shpallura fituese, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre fushën e kulturës (sektori i artit dhe kulturës, muzeve dhe prodhimeve kinematografike). Shuma e ndihmës shtetërore për secilën kategori janë shumë të kufizuara. Pra, ndikimi në konkurrencë është i kufizuar, edhe pse këta përfitues konkurrojnë me ndërmarrjet e tjera, të cilat nuk përfitojnë ndihmë sipas skemës.

11. Si rrjedhojë, në interpretim të nenit 4 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore" të ndryshuar, skema e ndihmës shtetërore e njoftuar përbën ndihmë shtetërore.

2. Ligjshmëria e ndihmës

12. Dhënia e ndihmës është objekt i miratimit të Komisionit të Ndihmës Shtetërore. Për këtë arsye, Ministria e Kulturës ka përmbushur detyrimin në përputhje me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, neni 13, shkronja "ç" "ndihma shtetërore që mund të lejohet", duke e njoftuar masën e ndihmës.

3. Përputhshmëria e skemës së ndihmës shtetërore

13. Në bazë të nenit 13, shkronja "ç", të ligjit nr. 9737 datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, ndihma shtetërore mund të lejohet nëse ajo "nxit zhvillimin kulturor dhe ruajtjen e trashëgimisë, deri në atë masë sa nuk ndikon ndjeshëm në kushtet e tregtisë dhe në konkurrencë".

14. Objektivi kryesor për miratimin e fondeve buxhetore është promovimi i veprimtarive, të mirave dhe shërbimeve kulturore, duke ofruar produkte kulturore të një rëndësie të lartë artistike në fushat e artit, muzeve dhe kinematografisë. Sipas informacionit të paraqitur nga Ministria e Kulturës, skema e ndihmës përmirëson performacën në art, mbajtjen dhe restaurimin e ndërtesave të muzeve publikë, prodhimin dhe shpërndarjen e filmit që kanë vlera cilësore dhe interes kulturor kombëtar duke përfituar artistët dhe publiku. Pra, skema synon të mbështesë aktivitete kulturore dhe të përmirësojë aksesin e publikut gjatë zhvillimit të tyre.

15. Paragrafët e mëposhtëm paraqesin një informacion të detajuar lidhur me mbështetjen dhe impaktin e saj në aktivitetet kulturore:

---

[2] State aid N 477/2008 – German Film Support Scheme, Germany

[3] State aid – SA.33470 (2011/N) – Hungarian Cultural Heritage, Hungary

[4] State aid 32643 (2011/N) – State aid to Basque Museums in 2011, Spain

[5] Formular aplikimi (B1) Projekt Kinematografik: nationalfilmcenter.gov.al/formulare/

[6] Thirrje për projektpropozime në art-kulturë, formular për aplikim për fonde dhe/ose mbështetje: www.kultura.gov.al/al/newsroom/njoftime/thirrja-per-projekt-propozime-2015.

- Arti dhe kultura

Mbështetja financiare e projekteve të paraqitura në fushën e artit dhe kulturës për vitin 2014 ishte 107 mln lekë.

- Muzetë

Mbështetja financiare për fushën e trashëgimisë kulturore dhe muzeve kombëtare për vitin 2014 ishte 75.97 mln lekë. Sipas përcaktimit në nenin 19, pika 1 e ligjit nr. 9386, datë 4.5.2005, "Për muzetë", financimi i muzeve publike me burime nga buxheti i shtetit mbulon shpenzimet për mbajtjen dhe restaurimin e ndërtesave muzeore, pagesën e shërbimeve të nevojshme, zgjerimin e ndërtesave muzeore, ruajtjen e tyre etj. Sipas të dhënave të Ministrisë së Kulturës rezulton se numri i vizitorëve në muzetë kombëtarë për vitin 2013 ishte 41,343 persona, ndërsa në vitin 2014 ishte 72,568 persona.

- Prodhimet kinematografike

Tabela pasqyron shumën e akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2014 dhe numrin e projekteve të realizuara.

Emri i produktit	**Fakti vjetor 2014**	**Nr. i projekteve që kanë përfituar ndihmë shtetërore**
Filma artistikë me metrazh të gjatë	47.455,0	5
Filma artistikë, vepër e parë	18.712,0	3
Film i shkurtër artistik	4.699,0	4
Filma dokumentarë	6.460,0	4
Filma vizatimorë	625,0	1
Fin. proj. festivale		4
Botime, aktiv.	90,0	
Proj. të ndryshme kinematografike	2.264,0	
TOTALI	**80.305,0**	**21**

16. Sa më sipër, qëllimi i skemës është kryesisht promovimi i një game të gjerë të aktiviteteve kulturore siç vërehet nga shumëllojshmëria e fushave kulturore të mbështetura në kuadër të skemës.

17. Karakteri kulturor i aktiviteteve është i reflektuar edhe në kriteret e zbatuara nga Kolegjiumi i Ministrisë së Kulturës për të zgjedhur projektet në fushën e artit dhe kulturës apo Këshilli Miratues i Projekteve për përzgjedhjen e projekteve në fushën e kinematografisë. Pra ndihma jepet direkt për mbështetjen e projekteve të mirëfillta kulturore.

18. Skema e ndihmës shtetërore është e nevojshme për të mbrojtur, për të nxitur dhe për të siguruar shpërndarjen e aktiviteteve kulturore, të cilat do të zhvillohen në vend, si dhe për të lehtësuar aksesin e publikut të gjerë ndaj tyre.

19. Aktivitetet që do të financohen në bazë të skemës janë jofitimprurëse dhe shumë prej tyre nuk do të kryheshin pa mbështetjen e shtetit. Pra, mund të konsiderohet se masa është e nevojshme dhe se ka formë nxitëse duke stimuluar kryerjen e investimeve private.

20. Sa më lart, Komisioni konsideron se masa është e nevojshme dhe proporcionale me objektiv promovimin e kulturës në vend dhe ka impakt të papërfillshëm në kushtet e tregtisë së lirë dhe të konkurrencës.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 13 shkronja "a", 17 shkronja "ç", 22 pika 2, 30 dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë ndihmën shtetërore për veprimtaritë, të mirat dhe shërbimet kulturore, mbështetur në nenin 13, shkronja "ç" të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, në përputhje me zhvillimin kulturor dhe ruajtjen e trashëgimisë, deri në atë masë sa nuk ndikon ndjeshëm në kushtet e tregtisë së lirë dhe të konkurrencës.

2. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

3. Ministria e Kulturës dhe Qendra Kombëtare e Kinematografisë në cilësinë e dhënësit të ndihmës brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar.

4. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Arben Ahmetaj